

SFIDA

MENAXHMENTI I MENÇUR SHKOLLOR: QASJA E INTEGRUAR DREJT QËNDRUESHMËRISË



QËLLIMI

Të inkurajojë rritjen e ndërgjegjësimit tek qytetarët, reduktimin e konsumit të energjisë, rritjen e efikasitetit të energjisë, reduktimin e emetimeve të gazrave të dëmshëm dhe mbrojtjen e mjedisit; gjegjësisht aktivitete për zhvillimin e teknologjive, shërbimeve dhe proceseve inovative që do të kontribuojnë në një konsum më optimal të energjisë elektrike.

Kjo sfidë realizohet nga Fondi për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik (Fondi) në partneritet me Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale (MVL) dhe në bashkëpunim me Ambasadën e Zvicrës në RMV për të mbështetur projektin “Zhvillimi i balancuar i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës - Faza”.

**Shkollat në të cilat
duhet të realizohet
dhe zbatohet
zgjidhja inteligjente
digjitale në
Rajonin planor
verilindor janë:**

- 1** "Goce Dellçev"
Kumanovë;
- 2** "Pero Nakov"
Kumanovë;
- 3** "Nace Bugjoni"
Kumanovë;
- 4** "Kiro Burnaz"
Kumanovë;
- 5** Konvikti studentor
"Prof. Mijalkoviç"
Kumanovë
- 6** "Gjorçe Petrov"
Kriva Pallankë;
- 7** "Mitko Penxhukliski"
Kratovë;
- 8** "Ismet Jashari"
Likovë
- 9** Konvikti studentor
"Mitko Penxhukliski"
Kratovë



ÇFARË ZGJIDHJESH MBËSHTESIM

- Reduktimi i konsumit të energjisë (duke zbatuar pajisjet IoT dhe modulet inteligjente). Duke zbatuar pajisje IoT për të kontrolluar, matur dhe optimizuar konsumin e energjisë në ndërtesë.
- Kontrolli dhe optimizimi i konsumit në pajisjet që përdorin energji elektrike, ngrohje dhe ajër të kondicionuar.
- Sistemet për paralajmërimin e hershëm dhe parandalimin e rrezikut dhe fatkeqësisë janë pjesë e veçorive të një ndërtese inteligjente për të reduktuar konsumin e panevojshëm të energjisë dhe në këtë mënyrë reduktimin e emetimeve të dëmshme të CO2.
- Sistemi i zgjuar për kontrollin e konsumit të energjisë në shkolla me monitorim dhe kontroll automatik të të gjitha dritave në shkolla.
- Sistemi do të dijë automatikisht kur të ndezë/fikë dritat, madje do të zvogëlojë ndriçimin në korridoret ku nuk ka lëvizje për momentin.

BUXHETI

**21.525.000
denarë**

**BUXHETI I
PËRGJITHSHËM
I THIRRJES**



- Fondi siguron mjete financiare në vlerë prej 12.300.000 denarë
- Ministria e Vetëqeverisjes Lokale siguron mjete financiare në vlerë prej 9.225.000 denarë.
- Për propozim projektin fitues, Fondi së bashku me MVL sigurojnë financim prej 100% të buxhetit të përgjithshëm për projektin.
- Zbatimi i projektit mund të zgjasë deri në 6 muaj.

KUSH MUND TË APLIKOJË

- të jetë shoqëri tregtare e themeluar në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të ardhurat vjetore të garuesit nuk duhet të kalojnë 10.000.000 euro në kundërvlerë me denarë, sipas raporteve financiare për dy vitet paraprake fiskale;
- numri mesatar i të punësuarve nuk duhet të kalojë 250 punonjës;
- nuk është i lidhur me një ndërmarrje tjetër dhe/ose OPSH, të ardhurat vjetore të së cilës i kalojnë 10,000,000 euro dhe se numri mesatar i të punësuarve nuk i kalon 250 në dy vitet paraprake fiskale, përveç rastit të lidhjes me një institucion të arsimit të lartë gjegjësisht një institucion kërkimor shkencor;
- ndaj tij nuk është ngritur procedura e falimentimit ose e likuidimit;
- të ketë shlyer detyrimet e maturuara në bazë të detyrimeve dhe kontributeve publike;
- ndaj tij nuk ka filluar procedura për ekzekutimin e detyrueshëm të kërkesave monetare të maturuara; dhe
- të jetë në pronësi shumicë dominuese maqedonase (me 51% ose më shumë)

AKTIVITETET E PROJEKTIT

Propozim projekti duhet të përfshijë aktivitete për zhvillimin ose aplikimin e teknologjive, shërbimeve dhe proceseve për të zbutur ose reduktuar konsumin e energjisë përmes një sistemi të unifikuar për monitorimin e konsumit të energjisë: Administratori do të jetë në gjendje të shohë të dhëna në kohë reale për konsumin total të energjisë së ndërtesës, statusin aktual të çdo pajisjeje IoT të përfshirë në sistem (konsumi i energjisë gjithashtu mund të monitorohet për çdo pajisje individuale) dhe gjithashtu të konfigurujë skenarë të ndryshëm.

AKTIVITETET MUND TË PËRFSHIJNË:

- Modul për menaxhim automatik të konsumit të energjisë
- Modul për riprogramimin manual të sistemit
- Modul për kontroll dhe qasje të shfrytëzuesve

SHPENZIMET E PRANUESHME PËR FINANCIM

- Pagat bruto me shtesat e pagës të përfshira, të përcaktuara në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve të Punës;
- Furnizimi dhe/ose huazimi i pajisjeve dhe materialeve harxhuese për hulumtim dhe zhvillim;
- Shërbime nga ekspertë të jashtëm/këshilltarë/konsulentë/nënkontrata (për hulumtime, zhvillim, testime, zhvillim biznesi etj.);
- shpenzime që lidhen me angazhimin e personave të jashtëm (personave fizikë dhe/ose juridikë) për shërbime hulumtuese dhe zhvillim, testim, zhvillim të biznesit dhe të ngjashme;
- Shpenzime të tjera operative të lidhura drejtpërdrejt me realizimin e projektit.

***Lista e shpenzimeve të pranueshme nuk është gjithëpërfshirëse.**

PROCEDURA E VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES

KONTROLLI ADMINISTRATIV I DOKUMENTEVE TË DORËZUARA

VLERËSIMI I PARË I PROPOZIM PROJEKTIT (PËRZGJEDHJA PARAPRAKE)

PITCHING GJEGJËSISHT PREZANTIMI I PROPOZIM PROJEKTEVE TË PARAPËRZGJEDHURA PËRPARA KOMISIONIT TË VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES (OPSIONALE)

PËRZGJEDHJA E PROPOZIM PROJEKTEVE MË TË MIRA

NËNSHKRIMI I MARRËVESHJEVE

KOMISIONI I VLERËSIMIT DHE PËRZGJEDHJES



Dy anëtarë – ekspertë të jashtëm në fushën e sfidës



Dy anëtarë – përfaqësues të organizatës partnere



Një anëtar – përfaqësues i Fondit

KRITERET E VLERËSIMIT



**SHKALLA E
INOVACIONIT**



**KAPACITETI I EKIPIT
TË PROJEKTIT**



**KUALITETI I
PROJEKTIT**



**POTENCIALI PËR ZBATIMIN DHE
QËNDRUESHMËRINË E ZGJIDHJES**



NDIKIMI

PRESIM APLIKIMET TUAJA!

AFATI I APLIKIMIT DERI MË: 5 tetor 2023, ora 14:00.

shkolskimenadjment@fitr.mk

www.fitr.mk

